

Dokumenti konsultues që përmban afatet e konsultimit, memorandumet shpjeguese dhe adresën për pranimin e komenteve për Projekt-Rregulloren për dhënien e titujve të nderit, mirënjohjeve dhe dekoratave të Komunës së Rahovecit

Projekt-Rregulloren për dhënien e titujve të nderit, mirënjohjeve dhe dekoratave të Komunës së Rahovecit gjendet në diskutim publik nga data **28.01.2022 deri me 28.02.2022**

Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet e përgjithshme dhe procedura për dhënien e titujve të nderit, çmimeve, dekoratave, mirënjohjeve dhe medaljeve nga Komuna e Rahovecit për qytetarët, personat juridik, shtetasit e huaj dhe organizatat e ndryshme për merita të veçanta dhe kontribute në Komunën e Rahovecit.

Fushëveprimi

Dekoratat, mirënjohjet dhe çmimet tjera u ndahen dhe jepen individëve, shoqatave, organizatave, personaliteteve që kanë ndikuar në fusha të ndryshme të veprimtarisë shoqërore si, humanizmit, kontributit kombëtar, kulturor, sportiv dhe aktivitete të tjera publike në Komunën e Rahovecit.

Përkufizimet

Me këtë Rregullore termat e mëposhtme kanë keto kuptime:

1. **"Dekoratë"** është çmimi që u jepet personaliteteve të vendit ose të huaj, si shenjë nderimi për arritje të veçanta personale dhe për kontribut të përgjithshëm shoqëror.
2. **"Mirënjohje"** është çmimi që u jepet qytetarëve si shenjë nderimi për kontribut in në të mirë të qytetarëve të Komunës së Rahovecit.
3. **"Medalje"** – është çmimi që u jepet individëve të caktuar për arritjet personale apo grupe në fusha të ndryshme të veprimtarisë shoqërore e sportive.

Propozimet për ndarjen e dekoratave dhe titujve të nderit

1. Dekoratat, titujt e nderit, mirënjohjet dhe çmimet, mund të propozohen nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, nga Kryetari i Komunës, nga shoqata apo organizata të shoqërisë civile, si dhe nga personalitete të dëshmuara nga jeta politike, kulturore, shoqërore, studiues e hulumtues të shquar shkencor.

2. Në propozim parashtruesi i propozimit duhet të arsyetojë propozimin me shkrim, me një përmbledhje të veprimtarisë dhe kontributeve të veçanta të të propozuarit.

Dorëzimi i dekoratës

1. Pas aprovimit të rregullores nga Kuvendi i Komunës për dhënien e dekoratave, Kryetari i Komunës ia dorëzon dekoratën solemnisht të dekoruarit.
2. I dekoruari - bartësi i titullit nënshkruhet formalisht në Regjistrin e Bartësve të Titujve të Nderit, regjistër ky që do të mbahet nga Zyrtari për Protokoll i Komunës.

3. Në rast se personaliteti nuk jeton më, pranimin e dekoratës mund ta bëjë anëtari i afërm i familjes apo personi i afërm i të dekoruarit.

Bartja dhe revokimi i titujve

1. Bartësi i titullit është i obliguar që titullin ta bartë me dinjitet, duke pasur parasysh çdo herë sjelljet e tij në jetë dhe angazhimin e përditshëm, si dhe të dëshmojë respekt për autoritetin që i'a ka ndarë titullin apo dekoratën (Kuvendit të Komunës së Rahovecit).

2. Bartësit të titullit mund t'i revokohet titulli, nëse konstatohet se me sjelljet e veta dëmton imazhin e dhënësit të dekoratës, si dhe cenon vlerat morale, atdhetare e humaniste.

3. Revokimi bëhet në procedurën e paraparë paraprake sikur për dhënien e titullit (shpërblimit), ndërsa vendimi përfundimtar merret në mbledhje të rregullt të Kuvendit të Komunës.

Përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje janë; Kryetari i Komunës së Rahovecit, Kuvendi i Komunës së Rahovecit dhe Drejtoritë përkatëse komunale.

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri me datën 28.02.2022 në ora 16:00, tek zyrtarët: Afrim.Dina@rks-gov.net; Muharem.A.Morina@rks-gov.net; Haziz.Krasniqi@rks-gov.net; Skender.Hamza@rks-gov.net dhe Blerta.Gashi@rks-gov.net